

# Projekti për Mbështetjen e Agrobiznesit në Shqipëri- Instrumenti i Ndarjes së Riskut për Bankën ProCredit

Vendi:	Shqipëri
Numri i Identifikimit të Projektit:	48326
Sektori i Biznesit:	Institucion Financiar
Institucion Privat	
Data e synuar në Bord:	20 Korrik 2016
Statusi:	Nënshkruar
Publikimi i PSD (Dokument Permbledhës i Projektit):	17 Qershor 2016

## Përshkrimi i Projektit

BERZH po ofron një instrument deri në 15 milionë Euro për Bankën ProCredit në Shqipëri (PCBA) me qëllim ndarjen e riskut, i cili do të mbulojë deri në 50% të vlerës së portofolit për kreditë e lëvruara për agrobizneset sipas kushteve kualifikuese të programit në Shqipëri. Projekti i propozuar është transaksioni i parë nëpërmjet ndarjes së riskut si pjesë e Programit për Mbështetjen e Agrobiznesit në Shqipëri. Projekti do të përfitojë gjithashtu nga një Skemë Mbulimi për Humbjet e Para, kontribut i Qeverisë Shqiptare, dhe asistencë teknike për: (i) Bankën ProCredit në Shqipëri me qëllim rritjen e kapaciteteve të huadhënies ndaj agrobizneseve dhe (ii) shërbime këshillimore për klientët ekzistues dhe potencialë të agrobiznesit të kësaj banke.

## Objektivat e Projektit

Qëllimi kryesor i Projektit është të promovojë dhe lehtësojë aksesin në financime për agrobizneset në Shqipëri duke e adresuar hendekun e financimeve si një nga sfidat kryesore për zhvillimin e sektorit.

## Ndikimi në Tranzicion

Ndikimi në Tranzicion do të vijë si rezultat i zgjerimit të tregut duke rritur huadhënien për fermerët dhe agrobizneset dhe nëpërmjet transferimit të njohurive, duke mbështetur PCBA për të rritur kapacitetet institucionale dhe marketingun, si dhe duke ofruar shërbime këshillimore për klientët ekzistues dhe potencialë të Bankës në sektorin e agrobiznesit.

## **Informacion për Klientin**

PROCREDIT BANK (ALBANIA) SH. A

Banka ProCredit në Shqipëri renditet e 10-ta për nga madhësia dhe është lider në huadhënien për SME-të dhe klientët agrobiznes. Totali i aseteve të bankës sipas të dhënave në Mars të 2016 përlllogaritet 242 milionë Euro dhe përbën 2.5% të totalit të aseteve bankare në Shqipëri. Banka ProCredit në Shqipëri është pjesë e grupit ProCredit, e cila drejtohet nga kompania mëmë e vendosur në Frankfurt, ProCredit Holding. Si pronari i vetëm i Bankës ProCredit në Shqipëri, ProCredit Holding zotëron 100% të aksioneve të PCBA.

## **Përmbledhja e Financimit të BERZH**

15,000,000.00 EURO

Deri në 15 milionë Euro.

## **Kostoja Totale e Projektit**

30,000,000.00 EURO

Deri në 30 milionë Euro.

## **Përmbledhja Sociale dhe Mjedisore**

Kategorizuar Institucion Financiar sipas Polititikës Sociale dhe Mjedisore 2014 të BERZH. Institucioni Financiar pjesëmarrës nën Programin për Mbështetjen e Agrobiznesit në Shqipëri duhet të adaptojë dhe implementojë Proçedurat e Menaxhimit të Riskut Mjedisor dhe atij Social të BERZH në përputhje me Kriteret e Performancës 2, 4 dhe 9 si dhe të dorëzojë Raportin Vjetor Mjedisor dhe Social për implementimin e proçedurave Mjedisore dhe Sociale dhe kriteret e performancës.

## **Bashkëpunimi Teknik**

Projekti do të shoqërohet me një paketë gjithëpërfshirëse të bashkëpunimit teknik me qëllim rritjen e kapaciteteve institucionale dhe zgjerimin e marketingut për bankën ProCredit në Shqipëri. Krahas kësaj, shërbimet këshillimore për kredimarrësit që do të ofrohen nga Ekipi për Këshillimin e Biznesit të Vogël të BERZH do të kenë për qëllim përmirësimin e njohurive dhe të shërbimeve jo-financiare të zhvillimit për agrobizneset në fusha që variojnë nga strategjitë deri tek operacionet dhe menaxhimi i cilësisë.

Së fundmi, paketa përfshin një vlerësim të të gjithë barrierave ekzistuese në sektorin e agrobiznesit që frenojnë mundësitë për financim të agrobizneseve, dhe gjithashtu ka potencial për aktivitete të mëtejshme mbi zhvillimin e kapaciteteve.

## **Informacion mbi Kontaktin e Shoqërisë**

ProCredit Bank Albania  
[informacion@procredit-group.com](mailto:informacion@procredit-group.com)  
+355 42 389 389  
[www.procreditbank.com.al](http://www.procreditbank.com.al)  
Rr. Dritan Hoxha; Nd. 92, H. 15, Njësia Bashkiake Nr. 11 Tirana, Albania

## **Mundësi biznesi**

Për mundësi biznesi ose prokurime, kontaktoni kompaninë e klientit.

Për projekte të sektorit shtetëror vizitoni faqen e Prokurimeve të BERZH  
Tel: +44 20 7338 6794  
Email: [procurement@ebrd.com](mailto:procurement@ebrd.com)

## **Pyetje të përgjithshme**

Për pyetje mbi projektet e BERZH që nuk lidhen me prokurimet:  
Tel: +44 20 7338 7168; Fax: +44 20 7338 7380  
Email: [projectenquiries@ebrd.com](mailto:projectenquiries@ebrd.com)

## **Politika e Informimit Publik (PIP)**

PIP përcakton mënyrën se si BERZH jep informacion dhe këshillohet me grupet e saj të interesit në mënyrë që të promovojë rritjen e ndërgjegjësimit dhe kuptimin e strategjive, politikave dhe aktiviteteve të saj.

Teksti i PIP mund të gjendet në: <http://www.ebrd.com/about/policies/pip/index.htm>

## **Mekanizmi i Ankesave për Projektet (MAP)**

BERZH ka krijuar Mekanizmin e Ankimimeve për Projektet (MAP) për të ofruar një mundësi për një shqyrtim të pavarur të ankesave nga një ose me shumë individë ose nga organizata për projektet e financuara nga Banka të cilat pretendohet të kenë shkaktuar ose që do të shkaktojnë efekte negative.

Rregullat e Proçedurës së MAP mund të shihen

në: <http://www.ebrd.com/about/integrity/irm/about/pcm.pdf>

Cdo ankesë sipas Mekanizmit të Ankesave për Projektet duhet të dërgohet brenda afateve të përshkruara në kodin e Rregullave dhe Proçedurave të MAP. Ju mund të kontaktoni për ndihmë punonjës in e MAP në ([pcm@ebrd.com](mailto:pcm@ebrd.com)) nëse jeni të paqartë mbi vlefshmërinë e ankesës tuaj.